

VENDIM
Nr. 5, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E DISA
NDRYSHIMEVE NË VENDIMET NR. 140, DATË 22.11.2013 DHE NR. 61, DATË 7.7.2014
“MBI RREGULLAT PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE TË
INTERKONJEKSIONEVE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 7.7.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”,

konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit harton rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit, e cila miratohet nga ERE në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- OST sh.a., me shkresën nr. 7166 prot., datë 16.11.2016, ka dërguar në ERE propozimin për disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 7.7.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 7.7.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet OST sh.a., MEI dhe Autoriteti i Konkurrencës për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti